



4 European
Union
Kosovo



Teknologjia tek fëmijët, ndikimi dhe pasojat

Instituti për Zhvillim dhe Integrim - IZHI

Raport hulumtues

Deklarata e përgjegjësisë: Ky manual u hartua në kuadër të projektit “Promovimi dhe Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijës”, që financohet nga Bashkimi Evropian dhe menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës në partneritet me forum ZFD. Përmbajtja e këtij manuali është përgjegjësi e organizatave zbatuese dhe në asnjë rrethanë nuk i atribuohet donatorit.

Autorë:

Dorina Muharremi

Lulzim Sejdiu

Njomza Kelmendi – Jasiqi

Vjollca Pireva–Kelmendi

Kontribuuesit:

Stafi i IZHI

Botuar nga:

Instituti për Zhvillim dhe Integrim, IZHI

Copyright © 2018 by INSTITUTI PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në ndonjë sistem për ruajtje, apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.



Implemented by:



Përmbajtja

- 1. Lista e tabelave**
- 2. Lista e figurave**
- 3. Hyrja**
- 4. Metodologjia e hulumtimit**
- 5. Shkollat e përfshira në hulumtim**
- 6. Të dhënat rreth hulumtimit**
- 7. Rezultatet e hulumtimit**
- 8. Pasojat tjera sipas hulumtuesve të ndryshëm**
- 9. Rekomandimet**
- 10. Referencat**

Lista e tabelave

Tabela 1: Ndarja e mostrës sipas shkollave

Tabela 2: Të drejtat e fëmijëve në pjesëmarrje

Tabela 3: Procesi i monitorimit

Lista e figurave

Figura1 : Qasja në Internet

Figura2: Informatat mbi rreziqet nga përdorimi i internetit

Figura3: Kontrolli i prindërve gjatë përdorimit të internetit

Figura4: Flejë vonë për shkak të internetit

Figura5: Kontaktimi me persona të dyshimtë

Figura6: Kam marr informacione nga të rriturit për ngacmimet në internet

Figura7: Informacionet në internet-privatësia

Figura8: Të tjetër flasin keq për mua në internet

Figura9: Kërcënimi në internet

Figura10: Shkolla informon vazhdimisht mbi ngacmimet në internet

Figura11: Prindërit dhe kujdestarët informojnë vazhdimisht mbi ngacmimet

Figura12: Interneti ndikon negativisht në mësimet

Figura13: Internetin e përdori më shumë për komunikim me të tjetër sesa për mësimet.

Figura14: Internetin e përdori.

Figura15: Internetin e shfrytëzoj

Figura16: Kam pasur ngacmime përmes internetit.

Figura17: Rreziqet që mund të kanosen nga interneti

Figura18: Ngacmimi në internet quhet

Figura19: Informimi në rast ngacmimi në internet

Hyrje

Qendra për Arsim e Kosovës dhe Forumi ZFD implementon projektin “Promovimi dhe Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijës”, në kuadër të thirrjes për propozime: Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut - EIDHR në përkrahjen e të drejtave të fëmijës, i cili ka për qëllim që t’i fuqizojë komunitetet lokale për t’i përmirësuar masat e mbrojtjes së fëmijëve në shkolla përmes vetëdijesimit, ndërmjetësimit dhe zgjidhjes paqësore të konflikteve.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është që të krijohen mjedise miqësore dhe pa dhunë për fëmijët nëpër shkollat e Kosovës përmes veprimeve të synuara të organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve lokale për promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Objektivi specifik i këtij projekti është zbatimi i politikave të mbrojtjes së fëmijëve dhe politikat më të mira nëpër shkollat e Kosovës duke i fuqizuar komunitetet shkollore që ta marrin drejtimin e procesit. Komuniteti i shkollave i përfshinë fëmijët, prindërit, mësimdhënësit, autoritetet lokale të arsimit, OSHC-të lokale dhe hisedarët tjerë relevantë. Objektivi specifik do të arrihet përmes aktiviteteve vetëdijesuese dhe duke krijuar mekanizma për ndërmjetësim dhe për zgjidhje paqësore të konflikteve në nivel shkolle.

Synimi i përgjithshëm i projektit është forcimi i OJQ-ve që punojnë në mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtat e fëmijëve, përmes dhënies së nën-granteve.

Instituti për Zhvillim dhe Integrim-IZHI, ka pasur fatin të jetë përfituese e këtij nën-granti ku si për qëllim kryesor në këtë projekt ka “Teknologjinë tek fëmijët, ndikimin dhe pasojat të cilën e realizon në zonat rurale të Komunës së Prishtinës respektivisht, në shkollat fillore të mesme dhe të ulëta në fshatrat Besi, Rimanishtë, Vranidoll, Tenezhdoll, Sharban, Prugovc, Barileve, dhe Graçanicë/ Llapnasellë.

Objektivë e përgjithshme e këtij hulumtimi ishte njohja rreth fenomenit të ndikimit të pajisjeve teknologjike tek fëmijët, nivelin e përdorimit, ekspozimin e tyre ndaj pajisjeve të mençura teknologjike, koha sa kalojnë në rrjetet sociale - youtube, facebook, Instagram, etj dhe ekspozimi i tyre në lojërat e rrezikshme on-line.

Kohëve të fundit mënyra e jetesës dhe ambienti në përgjithësi ka ndryshuar dukshëm. Disa prej ndryshimeve mund të jenë dendësia e ndërimit, trafiku i shtuar rrugorë, e shkaqe tjera që i bënë fëmijët të mos kenë aktivitete fizike fare. Kur i shtohet edhe zhvillimi i hovshëm i teknologjisë, bënë që fëmijët të rriten në një ambient virtual, duke marrë edukatë dhe informacione të pakontrolluara që sot i ofrojnë pajisjet teknologjike dhe qasja në internet. Përafërsisht deri në moshën 18 vjeç të rinjtë janë të dhënë pas atij që ndryshe quhet konsum mediatik, duke qenë shumë të ekspozuar para TV-së dhe internetit. Mirëpo, ajo që është kthyer në një sfidë dhe problem për shumë prindër janë video lojërat e ndryshme kompjuterike, qasja në incizime të

ndryshme të pakontrolluara nga askush, përfshirë këtu edhe lojëra të rrezikshme që dërgojnë edhe në vetëvrasje të fëmijëve.

Hulumtues të ndryshëm në gjithë botën si William Brian Arthur, Matthews B & Ross. Leti, theksojnë se video lojërat ndikojnë në rritjen e inteligjencës, qëllim i cili ndihmon njerëzit të përmbushin kërkesat e tyre në jetë si dhe llojllojshmëri të mundësive për të kuptuar një dukuri në shumë mënyra /audio/vizuale. Disa të tjerë thonë se përdorimi i lojërave ka shumë pasoja negative si p.sh qëndrim të keq të trupit që shkakton dëme në boshtin kurrizor, dëmtim të syve si dhe komunikim jo i drejtpërdrejtë pra anashkalim i të shikuarit sy më sy gjatë të folurit që është bazë për një bashkëbisedim të shëndoshësi dhe reflektim i jetës virtuale shumëherë i shkëputur nga jeta reale sidomos leximi i temave të ndryshme të pa selektuara apo të pabazuara në shkencë, obezitet, krijim i një fëmije neurotik, dëgjues pasiv, humbje e durimit dhe e vetëbesimit, ekspozim ndaj dhunës, ngarkesë psiko/fizike si dhe çrregullim në shëndetin mendor të fëmijëve etj.

Arritjet teknologjike kanë bërë që fëmijët të ekspozohen para pajisjeve teknologjike, shpesh edhe në mënyrë negative. Kjo ka prekur të gjitha moshat, por më të ekspozuar janë fëmijët nëpër zonat rurale ku mungon qasja në teknologji për aktivitete të ndryshme pozitive të fëmijëve si dhe vetëdijesimi përdorimit të teknologjisë duke u kanalizuar në përdorim me karakter edukativ /arsimor pothuajse i mangët si tek familjarët ashtu edhe në institucionet edukativo+arsimore. Nuk ka zona të caktuara me lodra dhe kënde të llojllojshme për fëmijë ku do të kalonin ditën e tyre gjatë pushimeve të gjata apo të shkurtra sa janë në shkollëpoashtu edhe pas orëve mësimore në lagje apo gjetiu në komunitet. Ne konsiderojmë se një hulumtim për përdorimin e teknologjisë tek fëmijët është i domosdoshëm në Kosovë, sidomos në zonat rurale të saj. Shumica e fëmijëve nëpër këto zona janë të ekspozuar në mjete të ndryshme teknologjike duke pasur qasje në rrjetet sociale, sidomos youtube dhe facebook pa ndonjë kontroll adekuat si nga familja ashtu edhe nga shkollat. Mos kontrollimi prindëror mund të bëjë që fëmijët të kenë qasje në video më përmbajtje eksplicite mbi moshë 18 vjeçare. Po ashtu, kureshtja e tyre për të kërkuar lojëra të ndryshme mund t'i ekspozojë ata edhe në lojëra të rrezikshme edhe të dhunshme online. Gjendja është alarmante dhe ende nuk ka ndonjë veprim konkret se çfarë qasje duhet t'i sigurohet fëmijës në internet dhe si ta vërtetojnë prindërit se ai po i ekspozohet lojërave të rrezikshme online.

Kosova ka kaluar në një periudhë të tranzicionit ku edukimi për partneritet nuk ka qenë dhe ende nuk është i trajtuar si duhet. Gjenerata të tëra janë formësuar pak a shumë në qëndrimet, aspiratat personale dhe të përbashkëta, në qëllimet e tyre zhvillimore prej asaj që i kanë pajisur sistemet formale të arsimit brenda koncepteve përkatëse dhe modeleve mendore. Arsimiti, trajnimet profesionale dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me rritjen e ndërgjegjes së mësimdhënësve dhe prindërve, janë thelbësore në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm për sjelljet pozitive të nxënësve në klasë si dhe formimi i një klime plot elan dhe shprehi pune për një

Implemented by:



ardhmëri të ndritur të tyre. Kjo njëherësh ndikon në përmirësimin e kapaciteteve arsimore dhe jep vullnet të madh në sistemin arsimor. E një rëndësie të veçantë është ngritja e kapaciteteve të komunitetit të gjerë për të kuptuar dhe pranuar përgjegjësitë e tyre sociale, ekonomike dhe mjedisore. Nisur nga kushtet aktuale dhe ato perspektive të zhvillimeve në shkollat e Kosovës, vlerësojmë se hapat duhen hedhur që nga fëmijëria e hershme në mënyrë që të plotësojmë nevojat e së tashmes.

Në një shoqëri demokratike janë kryesore dhe të rëndësishme respektimi i të drejtave të njeriut dhe fëmijës. Por një respekt i tillë nuk vjen vetvetiu, ai duhet të mësohet dhe të praktikohet. Shkolla është një institucion që na krijon mundësinë ta fillojmë këtë proces në një kohë kur fëmijët janë në moshën e formimit të qëndrimeve dhe të mendimeve të fëmijëve. Prandaj një nga detyrat më të rëndësishme të shkollës është të edukojë nxënësit me ndjenjën e demokracisë e të respektit për të drejtat njerëzore, të vetat dhe të të tjerëve.

Përdorimi i teknologjive digjitale në arsim filloi rreth gjysmë shekulli më parë. Ajo krijoi nevoja për të zhvilluar korniza konceptuale për pedagogji dhe strategji efektive për të rritur mësimin aktiv, të angazhuar dhe kuptimplotë të studentëve që do të çojë në rezultate më të mira mësimore.

Integrimi i teknologjive digjitale në kurrikulë ka për qëllim të mbështesë pedagogjinë inovative si dhe të përgatisë studentët për të ardhmen për punë dhe shtetësi. Megjithatë, pavarësisht nga ritmi i shpejtë i ndryshimit në teknologjinë digjitale, studimet vazhdojnë të tregojnë se niveli i teknologjisë, integrimi i tij në shoqëri dhe ndikimi i tij në klasë mbetet akoma në një nivel të ulët dhe aspak të kënaqshëm.

Sfida, megjithatë, ishte të prezantojmë filozofinë e teknologjisë në mënyrë të tillë që bëhet tërësisht e pranueshme për ata që nuk janë filozof. Këta jo filozof mund të jenë mësues dhe edukator të cilët mësojnë mësimdhënësit për të ardhmen teknologjike, apo kurse elementare për filozofinë e teknologjisë për studentët e inxhinierisë, pra edhe në kolegje apo universitete. Libri madje mund të apelojë te ata të cilët mësojnë rreth teknologjisë në nivel fillor apo të mesëm. Mund të ndihmojë në atë se çfarë duhet të mësojnë ata dhe shpresoj që të ju ndihmojë në nxitjen e mësimin në kuptim të asaj se çfarë do të thotë të përdorësh filozofinë teknologjike për mësim.

Carl Mitcham shkroi hyrjen në filozofi të teknologjisë për filozofët nën titullin “ThinkingThroughTechnology” (Të mendosh për teknologjinë). Më vonë, Joseph Pitt shkroi librin e tij për filozofinë teknologjike me titullin “ThinkingAboutTechnology” (Mendime rreth teknologjisë). Titulli i librit tim është “TeachingAboutTechnology” (Mësime për teknologjinë). Për ti dhënë fund këtij rrethi dikush mund të shkruaj një libër “TeachingThroughTechnology” (Mësim përmes teknologjisë). Ky libër megjithatë, nuk do të ishte për edukimin me teknologji por për

Implemented by:



teknologjinë edukative. Përderisa këto dy terma gjithmonë janë konfuz, dua të theksojë se libri i imë merret me edukim me teknologji dhe jo me teknologji edukative (edhe pse një kapitull i kushtohet përdorimit të teknologjisë për mësim rreth teknologjisë).

Studiuesi Holkneretal. (2008, fq. 85) thotë se “pas 5 dekadave të kompjuterëve në edukim, akoma ekziston konfuziteti i përdorimit të teknologjisë në klasë, si dhe frikë për ndikimin dhe përhapjen e tij.

Studimet e tjera po ashtu potencojnë se shumë mësimdhënës gjatë punës së tyre nuk kanë “lëvizur akoma nga gjërat bazike” të përdorimit të tyre në kompjuter siç është prezantimi në PowerPoint, video në You Tube, hulumtim në internet ose përpunim teksti. Çdo herë e më shumë po rritet diskutimi rreth asaj se sa është i vlefshëm dhe i qëndrueshëm përdorimi i teknologjisë.

Sipas Ito et al. “këto janë disa shkathtësi të cilat të rinjtë i zhvillojnë përmes ‘ngatërresave’ dhe hulumtimeve midis familjarëve dhe shoqërisë. Për edukatorët, këto janë sfida në përfshirjen e nxënësve /studentëve në kuptimin e plotë rreth përdorimit të teknologjinë në mësimdhënie, në ndërrimin e shprehive mësimore, p.sh të zhvillojë shkathtësitë për kërkime të veçanta në web faqe të ndryshme, dhe për zbatimin e përmbajtjes në punime shkencore akademike.

Me këtë qëllim, IZHI u mundua që të ngrit sa më shumë zërin dhe të jap kontributin e tij në mënyrë që fëmijët të cilët ekspozohen në rrjetet sociale t’i përdorin ato për dobinë e tyre, për qasje pozitive si : hulumtim, përpilim të temave, prezantimeve shkollore, përvetësimin e shkathtësive të shekullit 21 si dhe reflektimin e tyre tek fëmijët, etj, e jo për vendosjen në rrezik të jetës së tyre, siç mund të paraqitet në raste kërcënimi me emali, sms etj.

Gjatë hulumtimit nëpër shkolla janë studiuar shprehitë dhe përdorimi i internetit. Të gjeturat tregojnë se lidhjen me internet dhe të mirat e tij i shfrytëzojnë si zonat urbane ashtu edhe ato rurale.

Sipas të gjeturave të këtij studimi shumica e shprehive të përdoruesve të internetit janë të krahasueshme me trendet globale. Rrjetet sociale dhe shërbimet e komunikimit me zë përmes internetit shfrytëzohen kryesisht prej femrave, dhe se ky është gjithashtu një trend global. Kosovarët janë më aktivë në facebook sesa në rrjetet e tjera sociale, që është një prej kanaleve kryesore për të arritur tek një numër sa më i madh i përdoruesve.

Pa marrë parasysh të ardhurat familjare, kosovarët janë një shoqëri e lidhur me internet në një shkallë të ngjashme me vendet e zhvilluara. Në përgjithësi interneti është përdorur më së shumti për argëtim. Ky aspekt nuk ndryshon as në rastin e Kosovës, veçanërisht në ditët e sotme ku

Implemented by:



përdoret edhe për shoqërim. Ka edhe shumë shërbime të tjera të cilat i ofron interneti, por që vetëm këto në vijim janë marrë në shqyrtim. Nga pyetjet hulumtuese kemi ardhur në përfundim se fëmijët kanë pengesa shëndetësore gjatë përdorimit në mënyrë jo të duhur të internetit. Është rritur në mënyrë dramatike qasja në internet dhe kjo u lejon fëmijëve të përfitojnë nga një edukim “online”, po kjo nënkupton edhe sfida shumë të mëdha, pasi që fëmijët kanë një qasje të madhe në përdorimin e internetit, ndaj duhet të ndërmerren hapa për të nxitur përdorimin e ndërgjegjshëm të internetit pasi edhe fëmijët janë përdorues të tij.

Metodologjia

Kjo pjesë është një përshkrim i përgjithshëm i qasjes së aplikuar metodologjike gjatë këtij hulumtimi. Për të analizuar ndikimin e teknologjisë tek fëmijët si dhe pasojat nga përdorimi i pajisjeve teknologjike, ekipi i IZHI ka përdorur të dhëna primare të mbledhura përmes një ankete drejtuar nxënësve nga shkollat fillore në zonat rurale nga komuna e Prishtinës dhe Gracanicës.

Të dhënat primare janë mbledhur me anë të anketës, duke përfshirë nxënësit nga katër shkolla fillore në rajonin e Prishtinës. Mostra është ndërtuar bazuar në të dhënat nga katër shkollat partnere në dy komunat e përfshira.

Për t'u siguruar se ky hulumtim prodhon të dhëna reprezentative, mostra e përgjithshme është përbërë nga 390 respondent (nxënës) në katër shkollat partnere nga dy komunat, të cilat janë përzgjedhur në mënyrë rastësore me rastin e aplikimit për projekt duke i përfshi si partner implementues. Llogaritjet kanë treguar se një mostër prej 390 respondent është e mjaftueshme për të fituar rezultate reprezentative me një nivel të besueshmërisë prej 98përqind dhe margjinë të gabimit prej 2përqind.

Nga aspekti gjeografik, mostra e nxënësve të anketuar pasqyron një përafrim të shpërndarjes reale, në kuptimin e përfshirjes së hulumtimit vetëm në zonat rurale. Shpërndarja gjeografike e nxënësve është e ilustruar në Tabelën 1.

Përcaktimi i mostrës:

Implemented by:



Në bazë të të dhënave të mbledhura në secilën shkollë është përcaktuar mostra e hulumtimit në këtë mënyrë:

Nxënësit	Tërhiqen me short nxënësit e klasave VI-IX për pjesëmarrje në hulumtim.
Vranidoll-Sharban, Tenezhdoll	120 nxënës
Besi-Rimanishte, Prugovc	120 nxënës
Gracanicë-Llapnasell	70 nxënës të komunitetit serb
Barilevë	80 nxënës

Tabela 1.: Ndarja e mostrës sipas shkollave

Pas përcaktimit të mostrës, hapi tjetër ka qenë dizajnimi dhe hartimi i pyetësorit sipas seksioneve që ishin caktuar.

Pyetësori ka përmbajtur pyetje të përgjithshme lidhur me përdorimin e internetit nga nxënësit. Ndërsa pjesët kryesore të pyetësorit janë përbërë me pyetje që kanë për qëllim sigurimin e informatave lidhur me ngacmimet në internet, bullingun, fyerjet, kërcënimet, si dhe informatat mbi rreziqet që u kanosen nxënësve nga interneti.

Anketa është realizuar me angazhimin e anketuesve me përvojë, të cilët janë udhëzuar mbi specifikat e anketës. Të gjithë anketuesit janë udhëzuar, informuar dhe janë njoftuar lidhur me përmbajtjen dhe rëndësinë e anketës; janë aftësuar në metodologjinë e anketimit (kontakti me të anketuarin, mënyrat e mbledhjes së informatave, mënyrat e mbushjes së pyetësorit); dhe janë testuar mbi aftësinë e tyre për të kryer anketën përmes simulimit të një mostre të anketës.

Para fillimit të anketimit, pyetësori është testuar nga ekipi hulumtues i IZHI-it për të siguruar efikasitet të kohës dhe rrjedhën logjike të pyetjeve. Gjithsej janë angazhuar tre anketues.

Gjithashtu, secili pyetësor është verifikuar për të siguruar saktësi të plotësimit të pyetësorit dhe për të parë nëse ka përgjigje jo-logjike. Kjo metodologji përmirëson cilësinë e të dhënave dhe ndihmon në shmangien e defekteve të mundshme përbrenda vetë anketës.

Pasi janë mbledh të dhënat, janë koduar nga ekipi hulumtues me përvojë. Gjithashtu duke përdorur programin apo softuerin e posaçëm për këtë qëllim. Udhëheqësi i ekipit ka bërë gjithashtu kontrolle periodike, kryesisht përmes krahasimit të mesatares së variablave dhe shpërndarjeve në të gjitha skedaret, me qëllim për tu siguruar që të dhënat nuk janë ndryshuar me qëllim apo pa qëllim.

Procesi i monitorimit fillon me përcaktimin e qartë të fushave që do të analizohen pastaj, për secilën fushë definohe treguesit që do të përdoren gjatë monitorimit. Tabela e mëposhtme jep

Implemented by:



një pasqyrë të fushave dhe të treguesve që janë zhvilluar me pjesëmarrjen dhe kontributin e palëve relevante me interes.

Fusha	Treguesit
Shprehja e lirë e pikëpamjeve (Neni 12/13)	<ul style="list-style-type: none"> Fëmijët ndjehen të lirë t'i shprehin pikëpamjet e veta në shkollë, si në orët e mësimit, ashtu edhe gjatë aktiviteteve jashtëmësimore dhe kohës së lirë Fëmijët nuk ndëshkohen për shkak të shprehjes së lirë të pikëpamjeve të tyre Fëmijët inkurajohen nga të rriturit t'i shprehin pikëpamjet e tyre, si dhe që të kërkojnë, të marrin dhe të përcjellin informacion dhe ide.
Dinjteti i fëmijës (Neni 40)	<ul style="list-style-type: none"> Fëmijët janë të lirë ndjenjën e dinjtetit dhe vlerës së tyre. Fëmijët kanë të drejtë në jetën e tyre private. Fëmijët kanë të drejtë në kujdes, orientim, kontroll dhe këshilla.

Tabela 2.: Të drejtat e fëmijëve në pjesëmarrje

Organizimi i monitorimit

Pjesa qendrore e çdo procesi të monitorimit është mbledhja e të dhënave që kërkon një njohuri solide të burimeve të të dhënave, por edhe përcaktimin e një metodologji për mbledhjen e të dhënave. Pason përpunimi i të dhënave, po ashtu, sipas një metodologjie të paracaktuar dhe hartimi i raportit të monitorimit¹.

Ndarja e detyrave. – Në secilën nga 4 shkollat (të përzgjedhura në kuadër të projektit) është bërë përzgjedhja e 390 nxënësve të cilët do të jenë pjesë e hulumtimit.

¹Mattheës.B & Ross.L (England, 2010) – Metodot e hulumtimit. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane, cde, f.6.

Implemented by:



Dinamika e monitorimit. – Monitorimi është realizuar një herë brenda projektit sipas dinamikës së dhënë në tabelë:

Periudha	Raportimi
Dhjetor 2017	Pasqyra e të dhënave (mbledhja e numrit të nxënësve në shkolla)
Janar-shkurt 2018	Përpilimi i pyetësorëve dhe shpërndarja e tyre
Mars-prill 2018	Përpunimi i të dhënave
Maj-qershor 2018	Raporti gjithëpërfshirës

Tabela 3.: Procesi i monitorimit

Mbledhja e të dhënave. – Procesi u zhvillua në tri hapa:

1) Mbledhja e të dhënave demografike

Në fillim të projektit në secilën shkollë përfituese janë mbledhur të dhëna statistikore. Për mbledhje dhe përpunim të këtyre të dhënave është konsultuar në vazhdimësi drejtori i secilës shkollë duke pas parasysh edhe nevojën e secilës shkollë për problemin në fjalë.

3) Shpërndarja dhe mbledhja e pyetësorëve

Në terminin e caktuar, gjatë një ore mësimore ose pas orëve mësimore, të gjithë nxënësve të përzgjedhur për pjesëmarrje në hulumtim u janë shpërndarë pyetësorët, duke u lënë kohë të mjaftueshme që t'i plotësojnë. Mbledhja e pyetësorëve është bërë në atë mënyrë që të sigurohet anonimiteti.

Përpunimi i rezultateve dhe raportimi. – Përpunimi i rezultateve u organizua në këtë mënyrë:

1) Me të përfunduar raundi i monitorimit, janë futur të dhënat për çdo shkollë veç e veç në tabela të zhvilluara me ²softuer të veçantë Excel.

2) Pasi të jenë përpunuar të dhënat për shkollat ato janë analizuar dhe diskutuar në Komitetin për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës në shkollat pjesëmarrëse në hulumtim ku të ftuar kanë qenë edhe prindërit dhe mësimmhënësit e nxënësve. Me këtë rast, secili komitet ka pasur mundësi të bëjë komente duke dhënë shpjegime shtesë lidhur me të dhënat. Të dhënat dhe

²Mattheës.B & Ross.L (England, 2010) – Metodatat e hulumtimit. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane, cde, f.180.

komentet janë konfidenciale dhe janë diskutuar vetëm brenda shkollës. Në të ardhmen, këto rezultate do të prezantohen edhe në fokus grupe që organizohen në kuadër të projektit.

Shkollat e përfshira në hulumtim

SHFMU “Nënë Tereza”, Teneshdoll/Vranidoll

SHFMU “NexhmiMustafa”, Besi

SHFMU “MiladinMitic”, Lapljeselo/Gracanica

SHFMU “Ali Kelmendi”, Barilevë

1. Të dhënat rreth hulumtimit

Në vazhdim paraqiten të dhënat demografike të nxënësve që ishin pjesë e hulumtimit. Duket qartë se shfrytëzimi i adresës elektronike (email), facebook-ut, Skype dhe Youtube janë shërbimet kryesore të cilat shfrytëzohen në Kosovë. Për shkak të mungesës së opsioneve të pagesës online dhe të shkallës së ulët të interesit, Kosova nuk ka lëvizur shumë përpara sa i përket shërbimeve me pagesë online në krahasim, për shembull, me depërtimin e internetit. Ka edhe arsyeje të tjera si mirëqenia e përgjithshme e qytetarëve, mungesa e bashkërendimit mes bankave vendore, por edhe shërbimet e dërgesave që janë shumë pak të zhvilluara si në aspektin kombëtar ashtu edhe atë ndërkombëtar.

Nga ky rezultat shohim se një përqindje e fëmijëve kanë qasje në ueb faqe të cilat nuk janë për moshën e tyre dhe këta fëmijë mund të përballen me imazhe që ushqejnë jetën seksuale, një pjekuri e shpejtë seksuale e cila mund të rrit edhe numrin e aborteve te femrat, rrezikun nga shkarkimi i fotove të paligjshme, të parregullta, me përmbajtje seksuale nga pedofilët e cila mund të shkatërrojë frymëzimin e fëmijëve sepse fëmijët nuk janë të përgatitur psikikisht për atë që shohin apo dinë. Rreziku nga shikueshmëria e skenave të dhunës mund të sjellë te fëmijët agresivitet.

Shumë studime tregojnë se përdorimi i platformave sociale si Facebook e Twitter po ulë vetëbesimin e njerëzve dhe po shkakton ndjenjën e të qenit pavlerë. Kjo rrjedh si pasojë e krahasimit të individëve me miqtë e tyre dhe me postimet e tyre në platformat e ndryshme. Kjo shpeshherë i qon deri tek të menduarit se të tjerët po janë më të suksesshëm dhe po jetojnë një jetë më të lumtur e më interesante, prandaj dhe kjo mundë të jetë shumë shqetësuese, për fëmijët të cilët marrin gjëra tëservuara pa analizuar burimet apo mundësitëse a është e mundur të jetë ashtu ?!

Implemented by:



REZULTATET E HULUMTIMIT




Figure 20 : Qasja në Internet

Edhe nga hulumtimet tjera edhe nga publikimi i të dhënave nga regjistrimi i popullsisë del që përdorimi i internetit është pothuajse në çdo ekonomi familjare.

Në rastin e hulumtimit tonë del që fëmijët kanë deklaruar se kanë kompjuter në shtëpi dhe qasje në internet në 86% të tyre. Ndërsa vetëm 14% e tyre kanë deklaruar të kundërtën.

Nga ky pohim shohim dhe kuptojmë se interneti tashme në të gjitha shtresat e shoqërisë edhe i aplikueshëm dhe qasja në të është një standard dhe një nevojë e kohës.




Figure 21: Informatat mbi rreziqet nga përdorimi i internetit

Se ka rreziqe dhe pasoja nga përdorimi jo i drejt i internetit nga fëmijët është me se evidente dhe është vërtetuar me qindra raste, analiza, hulumtimet e raportet të ndryshme në Kosovë por edhe në vendet tjera.

Se sa janë të informuar fëmijët nga rreziqet apo dëmet së mund të shkaktoj internetit është me të vërtetë shqetësuese.

Nga hulumtimi del se rreth 25% e fëmijëve nuk kanë fare informacione mbi rreziqet apo dëmet që mund të shkaktoj përdorimi jo i drejt i internetit. Kjo është një përqindje shqetësuese për pasojat që mund t/i vijojnë këta fëmijë .

Implemented by:

Jam i/e vëzhguar nga prindi/kujdestari gjatë kohës kur e përdori internetin.




Figure 22: Kontrolli i prindërve gjatë përdorimit të internetit

Kur jemi tek vëzhgimi nga prindërit për mënyrën dhe kohën e përdorimit të internetit nga fëmijës shohim dhe fëmijët kanë deklaruar se ka një kontroll në shumicën e rasteve. Rreth 73% e të anketuarve kanë deklaruar se vëzhgohen nga prindi apo kujdestari, ndërsa 27% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk vëzhgohen apo kontrollohen fare nga prindi gjatë kohës së përdorimit të internetit që ndërlidhet me përqindjen e sipërshënuar.

Shpesh flejë vonë për shkak të përdorimit të internetit.




Figure 23: Flejë vonë për shkak të internetit

Nëse e analizojmë deklarin se fëmijët flejnë vonë për shkak të përdorimit të internetit, na del një e dhënë shqetësuese që prindërit duhet ta kenë parasysh tek fëmijët e tyre.

Të dhënat na dalin se 48% e fëmijëve deklarohen me PO, kur pyeten nëse flenë vonë për shkak të janë duke e përdorur shërbimet e internetit.

Ky fakt është jashtëzakonisht shqetësues dhe i dëmshëm për fëmijët e këtyre moshave. Prindërit në këtë rast duhet ta marrin përsipër menaxhimin e fëmijëve të tyre në këtë aspekt sepse gjumi si faktor kyç

për shëndetin mendor është në përmasa shqetësuese sa i përket përqindjes dhe duhet pas parasysh sa mund të jenë të dobishëm për agjendën e nesërme apo orarin mësimor që i pret këta fëmijë.

Implemented by:



Figure 24: Kontaktimi me persona të dyshimtë

internetit.




Figure 25: Kam marr informacione nga të rriturit për ngacmimet në internet

Se dëmet dhe pasojat negative nga përdorimi jo i drejt i internetit janë mese evidente dhe të natyrave të ndryshme vërtetohet edhe në rastin e pyetjes hulumtuese “nëse kanë pasur rast të kontaktojnë me persona të dyshimtë”.

Rreth 25% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë pas raste kur kanë kontaktuar me persona të dyshimtë. Është shqetësuese kjo përqindje kaq e madhe në këtë rast. Prindërit dhe mësimdhënësit duhet të angazhohen më tepër në këtë aspekt duke preventuar ndonjë rrezik që mund të kanoset nga ky komunikim përmes

Një prej brengave dhe shqetësimeve kryesore të prindërve është edhe ngacmimi që mund të vijë nga përdorimi jo i duhur i internetit.

Nga hulumtimi del që fëmijët në një përqindje prej 32% nuk kanë marr informacione, udhëzimi apo këshilla nga prindërit apo anëtarët tjetër të familjes mbi këto ngacmime.

Kjo shifër është shqetësuese nëse marrim parasysh rastet e fundit të fenomeneve të ndryshme që vijnë nga këto ngacmime. Komunikimi prindër /mësimdhënës /fëmijë paraqitet dukshëm i mangët .

Pasojat tjera sipas hulumtuesve të ndryshëm

Një studim i kryer në SHBA të 238 fëmijë të moshës 13-16 vjeçe, i publikuar në gazetën “Zemra Amerikane” tregon se shoqata gjeti se fëmijët që flinin më pak se 6,5 orë në natë, kishin tre herë më shumë gjasa të kenë presionin e gjakut të ngritur dhe mundësia për sulmet e ardhshme të

Implemented by:

zembrës të jetë më e mëdha. Hulumtuesit argumentojnë se aktivitetet e teknologjike në dhomën e fjetjes së adoleshentëve pushtojnë gjumin, përderisa atyre iu duhet të bëjnë 9 orë gjumë.

Përgjigjet e dhëna nga nxënësit lidhur me pengesat që ndikojnë në studimin e tyre gjatë përdorimit të internetit vijnë si: - 25.4 % shpesh ndikon negativisht, 29% ndonjëherë ndikon negativisht, 13.8% rallë ndikon negativisht, 25.6% asnjëherë nuk ndikon negativisht dhe 6.2% nuk kanë përgjigje.

Nga rezultatet e hulumtimit shohim se pavarësisht vetëdijes se interneti ndikon negativisht në zhvillimin e tyre, të rinjtë sërish nuk heqin dorë nga përdorimi i saj madje mundohen edhe të japin argumente tjera për të na bindur se një gjë e tillë duhet bërë sepse zhvillimi i gjithëmbarshtëm nuk bëhet ndryshe përveç se me përdorimin e internetit edhe nëse na dëmton.

Përqindja më e madhe është ajo e moshës 13-17 vjeç, moshë kjo e cila është më e ndjeshme dhe jo e lejueshme për të hyrë në facebook, sepse qasja në materiale traumatike, të dhunshme ose thjesht, nuk janë për një audiencë të mitur siç është moshja e tyre dhe mund të kenë efekte negative te këta fëmijë sidomos duke pas parasysh që qëndrojnë me një këmbë në fëmijëri dhe me tjetrën në adoleshencë pra një urë luhatëse vendimtare për të ardhmen e tyre nëcdo aspekt jetësor . Në bazë të rezultateve të fituara nga ky hulumtim del se të gjithë pjesëmarrësit në anketim, me përjashtim të një të anketuari, janë shfrytëzues të internetit.

Marrë parasysh pengesat në mësim, numri më i madh i nxënësve na tregon se nuk u pengon në mësim gjë e cila lë hapësirë për të dyshuar në sinqeritetin e tyre gjatë dhënies së informatave dhe bazuar në kohën e qëndrimit në teknologji . Hulumtimi tregon se një numër i nxënësve kontrollohen shumë pak nga prindërit e tyre.

Nga të dhënat e pjesëmarrësve në hulumtim shohim se fëmijët kanë qasje në ëeb faqe, të cilat nuk janë për moshën e tyre. Krahasuar sipas klasave shkollore, shihet se përdorimi më i madh i internetit është te klasat 7, 8 dhe 9. Sa i përket ndikimit negativ gjatë përdorimit të tepruar të internetit, përpos një numri shumë të vogël, të tjerët janë të vetëdijshëm për këtë ndikim. Opinionet e nxënësve lidhur me kohëzgjatjen e përdorimit të internetit, tregojnë se shumica e tyre internetin e përdorin disa orë. Nxënësit internetin e përdorin për të marrë njohuri, për lojëra të ndryshme, facebook. Krahasuar kohëzgjatjen e përdorimit sipas moshës, del se përqindja më e madhe e tyre janë të moshës 14-16 vjeç dhe qëndrimi në internet gjatë natës është te moshat e tyre dhe familjarëve të tyre që kanë deri në moshën 19 vjeç.

Përshkrimi i rezultateve

Implemented by:






Figure 26: Informacionet në internet-privatësia

Privatësia apo mbrojtja e të dhënave personale është një dukuri tjetër shqetësuese që prindërit duhet kenë kujdes me rastin e përdorimit të internetit nga fëmijët e tre. Siç e dimë mbrojtja e të dhënave personale është bërë problematike dhe shpesh ndikon dhe ka efektet tjera negative.

Nga hulumtimi del se fëmijët nuk kanë edhe shume njohuri mbi të dhënat personale. Se sa shpesh ata i shohin të dhënat e tyre të publikuara pa autorizim del se: 11% deklarojnë se shpesh i shohin të dhënat e tyre në internet. Dhe kjo është shqetësuese sidomos për të dhënat e fëmijëve që nuk janë në moshë madhore.




Figure 27: Të tjetër flasin keq për mua në internet

Shpesh here konfliktet ne mes bashkëmoshatarëve nxiten edhe përmes internetit, duke vazhduar pastaj edhe me fyerje dhe ngacmime verbale e fizike që dinë të përfundojnë edhe nëkahje të padëshiruar duke iu bazuar ekspozimit në masë tëfyerjeve dhe ngacmimeve .

Fëmijët rreth 14% kanë deklaruar se shpesh ndodhë që persona të ndryshëm flasin keq për ta në internet. Ndërsa 9% dhe 8% deklarojnë që ndonjëherë dhe rrallë të tjetër flasin keq për ta në internet. Edhe kjo shifër paraqitet si

indikator shqetësues nëse marrim si total të përgjithshëm.

Implemented by:

Ndodh që të kërcënohem nga persona të ndryshëm në internet




Figure 28: Kërcënimi në internet

Kërcënimi në internet është një fenomen tjetër shqetësues për fëmijët dhe të rinjtë që internetin e përdorin pa ndonjë kontroll.

Nga hulumtimi del një fakt shqetësues dhe që duhet kushtuar vëmendje nga të gjithë. Rreth 40% e të anketuarve kanë deklaruar se shpesh ndodh që kërcënohen nga persona të ndryshëm në internet.

Shkolla na informon vazhdimisht mbi ngacmimin në internet




Figure 29: Shkolla informon vazhdimisht mbi ngacmimet në internet

Se sa janë shkollat të angazhuara në dhënien e informacioneve apo këshillave për ngacmimet në internet, nga ky hulumtim na dalin këto të dhëna:

Fëmijët deklarojnë me 46% se “asnjëherë” nuk janë informuar nga shkolla për ngacmimet në internet. Rreth 12% deklarojnë se “rrallë” informohen nga shkolla për ngacmimet në internet. Rreth 24% deklarojnë “ndonjëherë” janë informuar për ngacmimet në internet. Ndërsa vetëm 12% kanë deklaruar se “shpesh” janë informuar për ngacmimet në internet. Ndërlidhet që komunikimi mesimdhënës /fëmijë rreth kësaj çështje është i mangët.

Implemented by:

Prindërit/kujdestarët më informojnë vazhdimisht mbi ngacmimet në internet.




Figure 30: Prindërit dhe kujdestarët informojnë vazhdimisht mbi ngacmimet

Interneti ndikon negativisht në mësimet e mija.




Figure 31: Interneti ndikon negativisht në mësimet

Kur jemi të ngacmimet dhe informacionet që marrin nxënësit nga prindërit dhe kujdestarët për këto ngacmime, atëherë del se 36% e respondentëve kanë deklaruar se asnjëherë nuk marrin këto informacione, për kundër që 32% deklarojnë që shpesh marrin këto informacione nga prindërit apo kujdestarët.

Është për tu brengos fakti që një shifër kaq e madhe e nxënësve deklarojnë që prindërit apo kujdestarët nuk kujdesen sa duhet për të dhënë këto informata apo për të dhënë këshilla të ndryshme në lidhje me ngacmimet në internet.

Edhe pse interneti përdoret mjaft nga fëmijët ata nuk ngurojnë ta pranojnë që përdorimi i tepërt apo jo i duhur ndikon negativisht në mësimet e tyre.

Nga të gjithë respondentet 25% prej tyre deklarojnë që “shpesh” interneti ndikon negativisht në mësimet e tyre. Rreth 29% deklarojnë se ndonjëherë ndikon negativisht, rreth 14% deklarojnë se rrallë ndikon negativisht, dhe 26% deklarojnë se asnjëherë nuk ndikon negativisht në mësimet.

Internetin e përdori më shumë për komunikim me të tjerët sesa për mësimet e rregullta




Figure 32: Internetin e përdori më shumë për komunikim me të tjetër sesa për mësimet.

Në pyetjen apo deklarin se internetin e përdori më shumë për të komunikuar me të tjetër se sa për mësimet, del se rreth 31% deklarojnë se shpesh e bëjnë një gjë të tillë, rreth 21% deklarojnë se ndonjëherë e bëjnë, ndërsa 21% deklarohen se asnjëherë nuk e përdorin internetin më shumë për të komunikuar se sa për mësimet.

Internetin e përdori....




Figure 33: Internetin e përdori.

Sa i përket vendit se ku të rinjë e përdorin internetin, rezultatet pak a shumë janë ato të pritshme, duke u bazuar në rrethanat aktuale .

77% deklarojnë që internetin e përdorin në shtëpi, me rreth 9% deklarojnë që internetin e përdorin në internet kafe, rreth 7% deklarojnë që internetin e përdorin edhe në shkollë, me 4% në rrugë dhe 3% diku tjetër.




Figure 34: Internetin e shfrytëzoj

Koha se sa shfrytëzohet interneti nga fëmijët gjatë 24 orëve po ashtu ka rëndësi të madhe në zhvillimin e tyre profesional dhe ndikimet e përgjithshme.

Nga hulumtimi del se 61% deklarohen se internetin e përdorin 2 ore në ditë. Rreth 16% deklarojnë që internetin e shfrytëzojnë 3 ore në ditë. Me rreth 4 ore në ditë deklarojnë 9% e të anketuarve, me 5 ore në ditë deklarojnë 7% e të anketuarve. Ndërsa është shqetësues fakti për këtë kategorinë prej 7% tjetër që deklarohen se internetin e shfrytëzojnë më shumë se 5 ore në ditë.




Figure 35: Kam pasur ngacmime përmes interesit.

Ngacimet në internet po thuajse janë bërë përditshmëri për të rinjtë që internetin e përdorin pa kurrfarë kontrolli. Është shqetësuese nëse marrim për bazë deklaratimet e fëmijëve në lidhje me përvojat e tyre apo rastet që u kanë ndodhur.

Rreth 48% deklarohen se kanë pasur kërkesa të ndryshme si formë ngacimi, pa e specifikuar çfarë lloji kërkesash. Rreth 21% deklarohen se janë ngacuar në internet. Rreth 20% deklarohen se kanë qene pjesë e fyerjeve në internet. Ndërsa paraqiten edhe të atillë që kanë pasur detyrim të ndryshme, me rreth 5%.




Figure 36: Rreziqet që mund të kanosen nga interneti

Kur jeni tek rreziqet që mund të kanosen nga përdorimi jo i drejt i internetit fëmijët kanë deklaruar: me 32% mendojnë që rreziku është nga personat që fyejnë dhe ofendojnë. Me 28% mënojnë që rreziku u kanoset përmes njohjes me pësona të huaj. Me 24% mendojnë që rreziku vjen nga kontaktet me njerëz vulgar, dhe 8% e shohin si rrezik personat që i publikojnë apo përdorin të dhënat personale.




Figure 37: Ngacim në internet quhet

Se çka mendojnë të rinjtë për shprehjen “ngacim në internet” shohim se “dërgimi i mesazheve ngacmuese” prinë me 41%, një pjesë prej 20% mendojnë që kërcënimimi është ngacim, po ashtu një pjesë tjetër prej 20% mendojnë që ngacim është postimi i fotove pa leje, dhe 14% mendojnë që fyerjet në internet janë ngacime.

Në rast ngacmimi, unë informoj...




Figure 38: Informimi në rast ngacmimi në internet

Në rastet kur fëmijët ngacmohen në internet në çfarëdo forme, nga pyetja se këndë e informojnë fillimisht dalin këtë të dhëna: me 81% e respondentëve deklarojnë që prindi e informojnë fillimisht, gjë që është mjaftë e mire. Me 9% deklarojnë se e informojnë vllahun apo motrën, pastaj një pjesë prej 6% u besojnë edhe shokut apo shoqeve, ndërsa veten 4% deklarojnë e informojnë kujdestarin e klasës.

Disa ekspertë janë të mendimit se me ndihmën e këtyre sajteve komunikimi mes njerëzve hyri në një fazë të re dhe njerëzit mund të mësojnë më lehtë dhe më shpejt mbi njëri tjetrin. Por nga ana tjetër, disa ekspertë janë të mendimit se rrjetet sociale si Facebook krijojnë edhe shumë probleme. Mbi bazën e studimeve të reja të kryera nga ³LarryRosen, profesor i psikologjisë në universitetin shtetëror të Kalifornisë, përdorimi tej mase i Facebook-ut mund të forcojë ndjenjën e mendjemadhësisë, të shtojë sjelljet antisociale, të krijojë emocione të forta dhe stres tek të rinjtë. Në studimin e Rosen është vërtetuar se përdoruesit e Facebook-ut, si fëmijët ashtu edhe të mëdhenjtë janë prekur nga sëmundje psikike. Sipas sajtit Facebook, çdo ditë në këtë sajt shtohen 200 mijë abonentë të rinj dhe ky rrjet i madh social ka qindra miliona abonentë. Popullariteti në rritje i këtij sajti me abonentë kryesisht të rinj, ka krijuar një perspektivë të konsiderueshme për lojtarët e mëdhenj e të pangopur të fushës së internetit dhe duket se secili prej tyre synon të kontrollojë një pjesë të këtij sajti.

Nga ana tjetër, ky sajt po shfrytëzohet edhe për realizimin e programeve politike dhe sociale. Rrjetet sociale si Facebook, në pamje të parë duket se janë ndërtuar për krijimin e një atmosfere për praninë elektronike të njerëzve në shoqëri. Por në brendësi, të gjitha këto rrjete janë në shërbim të qendrave mediatike dhe informative. Megjithatë regjistrimi në këto sajte është falas,

³[https://www.truthfinder.com/?utm_source=BINGNTF&traffic\[source\]=BINGNTF&utm_medium=Search&traffic\[medium\]=Search&utm_campaign=%2bLarry+%2bRosen&traffic\[campaign\]=http%3a%2f%2fTruthFinder.com:%2bLarry+%2bRosen&utm_term=&traffic\[term\]=&utm_content=&traffic\[content\]=&s1=%2bLarry+%2bRosen&s2=http%3a%2f%2fTruthFinder.com&s3=&s4=&s5=&traffic\[funnel\]=tf&traffic\[sub_id\]=%2bLarry+%2bRosen&traffic\[s2\]=http%3a%2f%2fTruthFinder.com](https://www.truthfinder.com/?utm_source=BINGNTF&traffic[source]=BINGNTF&utm_medium=Search&traffic[medium]=Search&utm_campaign=%2bLarry+%2bRosen&traffic[campaign]=http%3a%2f%2fTruthFinder.com:%2bLarry+%2bRosen&utm_term=&traffic[term]=&utm_content=&traffic[content]=&s1=%2bLarry+%2bRosen&s2=http%3a%2f%2fTruthFinder.com&s3=&s4=&s5=&traffic[funnel]=tf&traffic[sub_id]=%2bLarry+%2bRosen&traffic[s2]=http%3a%2f%2fTruthFinder.com)

në realitet asgjë nuk është falas dhe abonentët një pjesë të madhe të informacioneve të jetës së tyre private i vënë në shërbim të këtyre sajteve. ⁴Julian Assange, themeluesi i sajtit Wikileaks thotë: "Facebook është mjeti më i urryer i spiunimit i krijuar deri tani. Çdokush që shton në këtë sajt informacionet e tij dhe të shokëve dhe të afërmeve të tij duhet ta dijë se po u shërben falas organeve informative të SHBA." Sipas tij, Facebook është një thesar informacioni me emrat dhe të dhënat e njerëzve të cilat abonentët në mënyrë të pavetëdijshme i vënë në shërbim të këtij rrjeti social i cili shfrytëzohet nga shërbimet informative dhe agjenturore të Amerikës.

Përgjigjet lidhur me kohëzgjatjen e përdorimit të internetit nga nxënësit, na japin të kuptojmë se përqindja më e madhe e qëndrimit në internet është disa orë dhe kjo mund t'u shkaktojë fëmijëve efekte anësore, si në shëndet, ashtu dhe në mësim.

Nxënësit, internetin e përdorin për të marrë njohuri, lojëra të ndryshme, komunikim por ka edhe prej tyre që nuk japin arsye pse e përdorin. Nga ky rezultat shihet se pjesa më e madhe e përdoruesve janë në facebook, ku nga kjo paraqitet frika se fëmijët mund të jenë të rrezikuar të bëhen viktimat të abuzuesve seksualë, zënka në mes të fëmijëve përmes facebookut, njohje me persona të panjohur përmes facebookut, ndërkohë që fëmijët janë shënjestra më e mirë dhe më e lehtë për t'u arritur nga pedofilët.

2. REKOMANDIMET

Në bazë të këtij hulumtimi, ne mund të konstatojmë se qasja shfrytëzimin e internetit dhe rrjetit social nga ana e rinisë dhe fëmijëve, kryesisht për lojëra e rrjeteve sociale, dhe me kontroll jo adekuat nga ana e prindërve, rekomandojmë që në kurrikula shkollore, të lënda e Edukatës Qytetare, të parasheh tema të veçanta për dëmet dhe rreziqet që mund t'u kanosen fëmijëve si pasojë e shfrytëzimit të internetit për njëkohësi më të gjatë.

- Duhet të organizohen debate nëpër shkollë e qendra rinore, me tematikë rreth kësaj problematike.
- Qasja në internet të shërbejë për hulumtim, për gjetje të informacioneve të ndryshme që lidhen me projektet shkollore, hulumtime të ndryshme për tema të caktuara, përcjellja e risive që ndodhin në botë, sa i përket ngjarjeve që lidhen me moshën e tyre;
- Qasjen në internet ta përdorin maksimum 2 orë;

⁴https://en.wikipedia.org/wiki/Julian_Assange

- Sikurse duhet të ketë më shumë tema në media elektronike dhe televizive për dëmet që shkakton përdorimi i tepruar i internetit.
- Shkolla, mësuesit dhe autoritetet lokale duhet t'i kontrollojnë dhe parandalojnë fëmijët që të futen në faqe pornografike.
- Prindërit duhet të njoftohen për iniciativën e ndërmarrë nga Microsoft për shpërndarjen e një aplikacioni që quhet "Parentalcontrol", përmes të cilit mund të kontrollojnë kohën e përdorimit të internetit nga fëmijët e tyre.
- Sugjerohet që institucionet e Kosovës ta kenë parasysh themelimin e një Agjencie apo Departamenti Shoqërisë së Informacionit, ngjashëm me atë çfarë kanë bërë vendet fqinje (Maqedonia dhe Mali i Zi).

Në fund mund të themi se nga ky hulumtim kemi kuptuar dallime dhe ndryshime në mendime të nxënësve. Në disa raste këto dallime kanë qenë të faktorit gjinor por, jo gjithnjë. Andaj, duke pas parasysh gjendjen faktike në shkollat tona, kërkojmë angazhim më të madh nga ana e prindërve mbi kontrollin e fëmijëve në internet në mënyrë që të ndihmojmë zhvillimin e personalitetit të nxënësve, para se gjithash t'i edukojmë që ta duan e respektojnë së pari veten dhe të tjerët, të shprehin mendimin e tyre lirshëm me familjarët e tyre e jo në rrjete sociale me të huaj, të jenë pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme shkollore për tu bërë më vonë qytetarë aktiv dhe të devotshëm për shtetin e tyre.

Implemented by:



REFERENCAT

Sylhasi, V . “Edukimi për të drejtat e fëmijëve” – Doracak

Floëers, NancyKomposito(Manual e tëdrejtave të njeriut për fëmijët)

<https://childdevelopmentinfo.com/family-living/kids-media-safety/children-teens-web-internet-safety/#.Eë2ZhzSFPIU>

<https://kidshealth.org/en/parents/monitor-media.html>

<https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=K9kdIBIM424>

<http://toytheater.com/category/math-games/>

<http://www.k5learning.com/free-ëorksheets-for-kids>

<http://www.math-aids.com/>

<https://www.ixl.com/>

<https://www.homeschoolmath.net/worksheets/>

“TeachingAboutTechnology”

(An Intruduction to the PhilosophyforNon-philosophers)

Mark J. de Vries – Springerspublishing - WagNg

NewDigitalTechnology in Education(CeceptualizingProffesionalLearningforEducators),
SpringerPublishers

